



## **Komisionerët e Mbrojtjes së të Dhënave do të mbliidhen për Konferencën e 41-të Botërore në 2019 në Shqipëri**

### **Njoftim për shtyp i Presidentit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë**

20 korrik 2017

Konferenca Botërore e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) do të zhvillojë takimin e 41-të të saj vjetor në Tiranë, Republika e Shqipërisë, në tetor të 2019, njoftoi gjatë ditës së sotme z. John Edwards, Presidenti i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Botërore.

“Konferenca nuk është zhvilluar asnjëherë më parë në Ballkanin Perëndimor, ndaj është kënaqësi e veçantë, që do të kemi mundësinë të mbliidhemi në Shqipëri pas dy vitesh.

Megenëse është Konferenca kryesore në nivel ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë, është rast i mirë të mbliidhemi në një vend, i cili ka përjetuar tranzicionit drejt sistemit demokratik dhe të mësojmë nga një popull i cili i ka ende kujtimet e diktaturës më të ashpër komuniste të Evropës Lindore”, u shpreh z. Edwards.

Aktiviteti do të organizohet nga Zyra e Komisionerit për te Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Shqipërisë.

### **Historiku**

Konferenca Botërore e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë u zhvillua për herë të parë në vitin 1979. Konferenca ka qenë dhe mbetet forumi parësor botëror për Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave për katër dekada. Konferenca numëron 114 Autoritete anëtare të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë nga e gjithë bota.

Zyra e Komisionerit është Autoriteti i pavarur i mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri. Shqipëria është anëtarësuar në Konferencën Botërore që prej vitit 2010. Më shumë informacion rreth Zyrës së Komisionerit mund të gjeni në faqen zyrtare të saj: [www.idp.al](http://www.idp.al).

Datat e propozuara për zhvillimin e Konferencës janë 10-13 tetor 2019, gjithsesi këto data mbeten për t'u konfirmuar.

Përzgjedhja e shtetit mikpritës më shumë se dy vite më herët ka qenë një qëllim strategjik për Komitetin Ekzekutiv të Konferencës Botërore prej vitesh, në mënyrë që ky vend të ketë kohën e mjaftueshme për të organizuar një aktivitet të përmasave të tilla. Përzgjedhja në këtë mënyrë realizohet për herë të parë për Konferencën e vitit 2019 dhe ka si qëllim që të kthehet në një praktikë standarde për organizatorët e ardhshëm.

Për më shumë informacion, vizitoni lidhjen: <https://icdppc.org/> ose mund te kontaktoni Sekretariatit e Konferencës Botërore në adresën: [ExCoSecretariat@icdppc.org](mailto:ExCoSecretariat@icdppc.org).